

Mbi bazë të e nenit 158 – s pika 1), lidhur me nenin 225-a, 225-b dhe 225-v nga Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 27/02, 84/02, 98/02, 33/04, 88/05, 79/07, 08/08, 88/08, 56/09, 67/10 dhe 44/11), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve miratoi:

## **Rregullore për mënyrën e parashtrimit të ankimimeve të parashtruara në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve nga të siguruarit, përdoruesit e sigurimeve dhe nga palë të treta të dëmtuara**

### **Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1**

Me këtë rregullore përshkruhet nga afër mënyra dhe procedura e ankimimeve të parashtruara nga të siguruarit, nga përdoruesit e sigurimeve dhe nga palë të treta të dëmtuara, për çështje që kanë të bëjnë me sigurimet dhe ndërmjetësimin në sigurime nga ana e Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin e mëtejme Agjencia).

#### **Neni 2**

(1) Të siguruarit, përdoruesit e sigurimeve dhe palët e treta të dëmtuara, (në tekstin e mëposhtëm parashtrues i ankimimit) kanë të drejtë që të parashtrojnë ankimin në Agjenci për aktivitetin e shoqërive të sigurimeve dhe risigurimeve, shoqëritë e brokerimit në sigurime, shoqëritë e përfaqësimit në sigurime, përfaqësuesit në sigurime dhe Byronë Kombëtare të Sigurimeve (në tekstin e mëposhtëm (Subjekt)

(2) Nën termin ankimim, në bazë të kësaj rregulloreje, nënkuptohet çdo shkresë nga ana e parashtruesit të ankimimit adresuar në Agjenci për shkak të mbrojtjes dhe realizimit të së drejtave dhe interesave të tyre.

(3) Nëse në emër të parashtruesit të ankimimit, ankimi parashtrohet nga një person tjetër, detyrimisht duhet që të ketë të bashkangjitur autorizim të vërtetuar në noter.

### **II. Mënyra e parashtrimit të ankimimit**

#### **Neni 3**

(1) Parashtruesi i ankimimit ka të drejtën që të parashtrojë ankimim në Agjenci vetëm nëse paraprakisht me shkrim i është drejtuar Subjektit dhe gjatë kësaj ai nuk është i kënaqur nga përgjigjja ose nëse Subjekti nuk ka vendosur lidhur me ankimimin dhe nuk e ka njoftuar me

shkrim parashtruesin e të njëjtës në një afat prej 30 ditësh, nga dita kur ankimi në formë të rregullt është parashtruar tek Subjekti.

2) Agjencia nuk do t'i shqyrtojë ankimimet për të cilat zhvillohet procedurë gjyqësore ose për të cilat tashmë është marrë një aktvendim gjyqësor ose vijon ndonjë procedurë tjetër.

3) Agjencia nuk i shqyrton ankimimet të cilat janë anonime.

#### **Neni 4**

- 1) Ankimimi i parashtrohet Agjencisë në formë të shkruar ose në formë elektronike.
- 2) Ankimimi duhet të përmbajë:
  1. Emrin dhe mbiemrin dhe adresën/emërtimin dhe selinë e parashtruesit të ankimimit.
  2. Përshkrimin e prodhimit, respektivisht shërbimit për të cilin parashtruesi i ankimimit, ankohet.
  3. Subjekti kundër të cilit parashtrohet ankimimi
  4. Dokumentacioni bashkangjites duhet të përmbajë:
    - kopje nga marrëveshja për sigurimin ( nëse ekziston
    - kopje nga ankimi i parashtruar tek Subjekti
    - përgjigjen e dhënë nga Subjekti lidhur me ankimimin dhe
    - dokumentacionin tjetër të nevojshëm për të marrë vendim lidhur me ankimimin e parashtruar.
- 3) Nëse ankimimi parashtrohet në formë elektronike, dokumentacioni nga paragrafi (2) pika (1) i këtij neni duhet të parashtrohet i skenuar së bashku me mesazhin elektronik.

#### **Neni 5**

- (1) Agjencia i parashtron kopje nga ankimimi, Subjektiti kundër të cilit është parashtruar ankimim, me kërkesë që Subjekti të deklarohe lidhur me pikat të cituara në ankimim.
- (2) Me qëllim të konfirmimit nëse ankimimi është i bazuar apo jo, Agjencia mundet që të kërkojë nga Subjekti, kundër të cilit është parashtruar ankimim, në shqyrtim të gjithë lëndën lidhur me të cilin është parashtruar ankimimi, si dhe një dokumentacion dhe informacion shtesë.
- (3) Subjekti kundër të cilit është parashtruar ankimimi është i detyruar që të parashtrrojë përgjigje me shkrim në Agjenci në një afat prej 5 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.
- (4) Agjencia e shqyrton ankimimin dhe parashtruesit të ankimimit i parashtron përgjigje me shkrim në një afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së ankimimit.
- (5) Nëse Agjencia vlerëson se kjo është në dobi të zgjidhjes së ankimimit, mundet që të kërkojë ballafaqim me palët e prekura me qëllim që përmes një marrëveshje

reciproke, palët të gjejnë një zgjidhje që do t'i përmbushë interesat reciproke lidhur me kriterin e ankimimit.

- (6) Agjencia mban evidencë për ankimime të parashtruara dhe të zgjidhura.

### **III. Shpenzime për parashtrimin e ankimimeve dhe zgjidhja paqësore e kontesteve**

#### **Neni 6**

Të gjitha shërbimet që janë të lidhura me procesin e parashtrimit të ankimimeve, që i siguron Agjencia, janë të liruara nga shpenzimet.

### **IV. Konfidencialiteti e të dhënave**

#### **Neni 7**

Agjencia është e detyruar që të respektojë parimin e konfidencialitetit të informacioneve që janë të aksesueshme në procesin e procedurës së ankimimit.

### **V. Dispozita përfundimtare**

#### **Neni 8**

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

**Në Shkup**

**Kryetari i Këshillit të Ekspertëve  
të Agjencisë**

**Nr.0201-4197/2**

**13.12.2011**

**Dr. Klime Poposki**